UDHËZIM
Nr.20, datë 8.9.2011

PËR METODAT DHE PROCEDURAT E RAPORTIMIT TË SUBJEKTEVE RAPORTUESE TË LIGJIT NR.9917, DATË 19.5.2008 "PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe të nenit 28, pika 3 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit"", me propozim të autoritetit përgjegjës, Ministri i Financave

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë mënyrat dhe procedurat e raportimit, afatet kohore, standardet dhe kriteret që duhet të përdorin subjektet e përcaktuara në nenin 3, shkronjat "a", "b", "c", "ç", "d", "e", "ë", "f" dhe "k" të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar, në funksion të zbatimit të këtij ligji.

Neni 2
Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë udhëzim do të kenë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 2 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllim dhe zbatim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm do të kenë këtë kuptim:

"Raporti i aktivitetit të dyshimtë" (RAD) është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, me anë të të cilit subjektet raportojnë tek autoriteti përgjegjës për çdo transaksion dhe aktivitet të dyshimtë.

"Raporti i transaksionit të parasë fizike" (RTPF) është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi me anë të të cilit subjektet raportojnë tek autoriteti përgjegjës çdo transaksion në para fizike në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë ose kundërvlera në monedha të tjera të huaja, të kryer si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën.

"Raporti i transaksionit të vlerave" (RTV) është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, me anë të të cilit subjektet raportojnë tek autoriteti përgjegjës çdo transaksion jo në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë ose kundërvlera në monedha të tjera të huaja, të kryer si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën.

"Raporti i vetëkontrollit" është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe që plotësohet dhe raportohet nga subjektet me kërkesën e "autoritetit përgjegjës", në lidhje me përmbushjen prej tyre të detyrimeve ligjore.

Neni 3

Identifikimi dhe verifikimi i klientit dhe pronarit përfitues

1. Në zbatim të nenit 4 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar, subjektet bëjnë identifikimin e klientëve (të vazhdueshëm apo rastësor) dhe verifikimin e identitetit të tyre me anë të dokumenteve të vlefshme origjinale ose fotokopjeve të noterizuara:

a) Për individët dhe përfaqësuesit ligjorë:

- Letërnjoftim ID (kartë identiteti);
- Pasaportë brenda afatit të skadencës.

Për individë jorezidentë:

- Pasaportë, brenda afatit të skadencës;
- ID, kartë identiteti (vetëm për vendet e BE-së), brenda afatit të skadencës.

b) Për personat fizikë dhe juridikë që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:

- Statuti;
- Akti i themelimit;
- Ekstrakte të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
- NUIS/NIPT.

Për shoqëri jorezidente:

- Dokumentacioni që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në vendin e rezidencës (vendim i gjykatës ose ekstrakt nga regjistri tregtar);
- Statuti i shoqërisë;
- Dokumenti i identifikimit të personave të autorizuar.

c) Për personat juridikë që nuk zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:

- Akti i themelimit të shoqërisë;
- Statuti i shoqërisë;
- Vendimi i gjykatës për regjistrimin si person juridik.

2. Dokumente të tjera shtesë që mund të kërkohen nga subjekti, por pa u kufizuar vetëm në to, sipas nevojës për identifikimin dhe për verifikimin e identitetit të klientit, si dhe në të gjitha rastet kur ka të dhëna ose dyshime për pastrim parash ose financim të terrorizmit janë:

a) Për individët dhe përfaqësuesit ligjorë:

- Certifikata të lëshuara nga zyrat e gjendjes civile;
- Diploma shkollore/universitare;
- Leje drejtimi e automjetit;
- Leje hyrje apo qëndrimi për të huajt;
- Libreza apo kontratë pune;
- Kontrata e blerjes/qirasë së banesës;
- Kontrata me operatorë shërbimesh, si telefon fiks, celular, ujë, energji elektrike, etj;
- Vërtetim vendbanimi të lëshuar nga autoritetet vendore.

b) Për personat fizikë dhe juridikë që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:

- Certifikatë regjistrimi të personit të tatueshëm;
- Leje/licencat e ushtrimit të aktivitetit;
- Kontrata e blerjes/qirasë së selisë dhe vendit të ushtrimit të aktivitetit.

c) Për personat juridikë që nuk zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:

- Certifikatë regjistrimi të personit të tatueshëm;
- Leje/licencat të ushtrimit të aktivitetit;
- Kontrata e blerjes/qirasë së selisë dhe vendit të ushtrimit të aktivitetit.

3. Identifikimi i klientëve bëhet gjithnjë nga subjektet dhe mbështetja te palët e tjera për kryerjen e këtij procesi nuk është e lejueshme.

4. Subjektet duhet të identifikojnë dhe të verifikojnë identitetin e pronarit përfitues. Në rastet kur klienti është person juridik, duhet kryer identifikimi dhe verifikimi për zotëruesit

përfundimtarë të personit juridik duke kërkuar dokumente shtesë, të cilat provojnë identitetin dhe lidhjen e pronarit përfitues apo zotëruesit përfundimtar me personin juridik dhe me atë që kryen transaksionin.

5. Në rastet kur klienti apo pronari përfitues është një kompani aksionare e listuar në një bursë të njohur financiare jashtë vendit dhe është subjekt i detyrimeve për raportim në një autoritet rregullator, nuk është e nevojshme të identifikohet dhe verifikohet identiteti i aksionarëve të kompanisë. Për qëllime të këtij udhëzimi, bursë e njohur financiare do të konsiderohen bursat e vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.

Neni 4
Vigjilenca e duhur ndaj klientit

Në kuadrin e zbatimit të vigjilencës së duhur ndaj klientit, subjektet:

1. Duhet të hartojnë e të zbatojnë rregullore dhe udhëzime të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

2. Duhet të marrin masa për të kuptuar strukturën e pronësisë e të kontrollit të klientëve, që janë persona juridikë dhe për të përcaktuar se cilët janë individët që kanë në pronësi apo kontrollojnë klientin. Këtu përfshihen ata individë që ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv mbi personin juridik.

3. Duhet të marrin miratimin e instancave më të larta të administrimit/drejtimit dhe të dokumentojnë respektivisht për çdo institucion përgjegjësitë përkatëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, përpara se të vendosin marrëdhënie biznesi për shërbimet bankare korrespondente.

4. Që para vendosjes së marrëdhënieve të biznesit apo gjatë procesit të monitorimit të kësaj marrëdhënieje, duhet të përcaktojnë për të gjithë klientët nëse ata janë duke vepruar në emër të një personi tjetër dhe duhet të marrin masa të arsyeshme për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e atij personi;

5. Duhet të sigurojnë informacion për qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit me klientin.

6. Duhet të përcaktojnë procedurat dhe mjetet e menaxhimit të riskut për rastet kur klienti lejohet të vendosë dhe të përdorë marrëdhënien e biznesit para verifikimit të identitetit. Këto procedura duhet të përfshijnë një sërë masash, si kufizimin e numrit, të llojit dhe/ose të shumës së transaksioneve që mund të kryhen.

7. Në rastet kur subjekti ka filluar marrëdhënien e biznesit, sipas pikës 6 të këtij neni, dhe si rezultat i mosparaqitjes së dokumenteve nga ana e klientit është i paaftë të zbatojë detyrimin e vigjilencës së duhur, të përshkruar në këtë nen, duhet të përfundojë marrëdhënien e biznesit dhe të dërgojë raport të aktivitetit të dyshimtë tek autoriteti përgjegjës.

8. Subjektet duhet të zbatojnë këto masa për vigjilencën e duhur edhe ndaj klientëve ekzistues, bazuar në të dhëna, fakte dhe nivelin e riskut të ekspozimit të tyre ndaj pastrimit të produkteve të veprave penale apo financimit të terrorizmit.

Neni 5
Vigjilenca e zgjeruar

Në funksion të zbatimit të vigjilencës së zgjeruar, subjektet e këtij udhëzimi:

1. Duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve komplekse, me vlera të larta dhe të pazakonta, të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor dhe njëkohësisht të analizojnë arsyet dhe qëllimin e kryerjes së transaksioneve të tilla. Të dhënat mbi konkluzionet e analizave duhet të mbahen për një periudhë pesëvjeçare dhe t'u vihen në dispozicion autoritetit përgjegjës, autoriteteve mbikëqyrëse/licencuese dhe auditorëve të

brendshëm apo të jashtëm.

2. Subjektet e germës "a" të nenit 3 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar:

- duhet të marrin masat e duhura, në mënyrë që të sigurohen se bankat e huaja korrespondente nuk lejojnë që llogaritë e tyre të përdoren nga bankat guaskë;
- nuk duhet të mbajnë marrëdhënie korrespondente me banka, llogaritë e të cilave përdoren nga bankat guaskë;
- Në rastet kur evidentojnë apo konstatojnë se llogaritë e bankës korrespondente përdoren nga bankat guaskë, ato duhet të ndërpresin menjëherë marrëdhënien e biznesit dhe t'i raportojnë autoritetit përgjegjës.

3. Të përfshijnë në rregulloret dhe procedurat e brendshme politikat e menaxhimit të riskut për të përcaktuar, ndër të tjera, nëse një klient apo personat e lidhur me të janë persona të ekspozuar politikisht. Në këtë kontekst subjektet:

a) duhet të kërkojnë informacion në burimet e disponueshme, të tilla si: lista e përditësuar e personave të ekspozuar politikisht vendas, bazat specifike të të dhënave (Worldcheck, Factiva, etj), si dhe burimet e hapura të informacionit për personat e huaj;

b) duhet të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vendosjen e marrëdhënieve të biznesit apo vazhdimin e këtyre marrëdhënieve kur një klient ekzistues bëhet person i ekspozuar politikisht;

c) duhet të kryejnë një monitorim në rritje dhe të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me këta klientë.

4. Të përfshijnë në rregulloret dhe procedurat e brendshme politikat e menaxhimit të riskut për organizata jofitimprurëse. Në këtë kontekst, subjektet:

a) duhet të kërkojnë dhe marrin të dhëna mbi natyrën e veprimtarisë, administrimit dhe drejtimit të tyre, si dhe burimin e fondeve;

b) duhet të hartojnë dhe zbatojnë procedurat e menaxhimit të riskut;

c) duhet të kryejnë një monitorim në rritje dhe të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me këta klientë.

5. Të përcaktojnë nëse klientët janë duke vepruar në emër të një personi tjetër dhe duhet të marrin masa të arsyeshme për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e atij personi.

6. Nëse subjektet nuk mund të zbatojnë detyrimin e vigjilencës së zgjeruar:

a) nuk duhet të hapin llogari, të fillojnë një marrëdhënie biznesi apo të kryejnë transaksionet;

b) duhet të dërgojnë raport të aktivitetit të dyshimtë tek "autoriteti përgjegjës".

Neni 6

Monitorimi i vazhdueshëm i marrëdhënieve të biznesit

Subjektet duhet të kryejnë monitorim të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me klientin. Ky monitorim duhet të përfshijë analizimin e transaksioneve të kryera gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj marrëdhënieje, për t'u siguruar se ato janë në përputhje me njohuritë që subjekti ka për klientin, natyrën e biznesit të tij dhe profilin e riskut, si dhe burimin e fondeve.

Subjektet duhet të sigurohen nëpërmjet rishikimit të dosjeve të klientëve që dokumentet, të dhënat dhe informacioni i mbledhur gjatë procesit të vigjilencës së duhur përditësohet dhe është koherent. Ky proces kërkohet të ndërmerret veçanërisht për klientët apo marrëdhëniet e biznesit që kategorizohen me risk të lartë.

Neni 7

Organizimi dhe përgjegjësitë e strukturës raportuese të subjektit

1. Subjektet raportuese të këtij udhëzimi duhet të krijojnë një strukturë për të parandaluar përdorimin e subjektit për pastrim parash dhe financim të terrorizmit.

2. Subjektet duhet të emërojnë një person përgjegjës dhe një zëvendëspërgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave në nivele administrimi/drejtimi në zyrën qendrore dhe në çdo zyrë përfaqësimi, filial, degë ose agjenci, te të cilët të gjithë punonjësit raportojnë çdo fakt që mund të përbëjë dyshim për pastrim parash ose financim terrorizmi.

3. Në rast se numri i punonjësve të subjekteve është më pak se tre persona, detyrimet e këtij neni përmbushen nga administratori ose nga një punonjës i autorizuar i subjektit dhe nuk kërkohet hartimi i një rregulloreje të veçantë.

4. Subjektet duhet t'i trajnojnë periodikisht punonjësit e tyre përmes një programi vjetor për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, përfshirë këtu edhe njohjen me ndryshimet ligjore në këtë fushë. Trajnimet e zhvilluara dokumentohen dhe u vihen në dispozicion përfaqësuesve të "autoritetit përgjegjës", kur një gjë e tillë kërkohet prej tyre.

Neni 8

Shërbimet e transferimit të parave ose të vlerave

1. Subjektet kërkojnë nga institucionet financiare nga ku dërgohen transferta, të dhëna për dërguesin, të cilat merren përmes formularit që shoqëron transfertën, në të cilin duhet të përfshihen këto të dhëna:

- emri;
- mbiemri;
- vendbanimi dhe vendqëndrimi;
- numri i dokumentit të identifikimit;
- numri i llogarisë së dërguesit dhe në mungesë të tij numri unik i referencës;
- emri i institucionit financiar nga ku niset transferta;
- përshkrimi i dërgesës.

2. Nëse subjektet që kryejnë transferta parash ose vlerash, për të cilat nuk arrijnë të sigurojnë informacionin bazë sipas pikës 1 të këtij neni, subjektet refuzojnë pranimin e transfertës dhe ia raportojnë këtë rast "Autoritetit përgjegjës" menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.

Neni 9

Raportimi i aktiviteteve të dyshimta tek autoriteti përgjegjës

1. Subjektet i paraqesin raport autoritetit përgjegjës, në të cilin parashtrojnë dyshimet që kanë për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale apo financimi i terrorizmit. Raportimi bëhet me anë të formularit (RAD) menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.

2. Ky raportim kryhet pas shqyrtimit të plotë të elementeve të dyshimta dhe të dhënave që subjektet kanë në dispozicion për ta arsyetuar atë, pavarësisht shumës së transaksioneve të kryera/ose që janë duke u kryer/ose që do të kryhen.

3. Formulari (RAD) duhet të shoqërohet me të gjithë informacionin e nevojshëm, që mbështet dyshimet e parashtruara në raport, si: nxjerrjen e llogarisë bankare, dokumentet e identifikimit, të dhënat e transfertave, kontratat, etj., dërgohet i plotë me shkresë zyrtare.

4. Në raste urgjente subjektet mund ta përcjellin informacionin për aktivitetin e dyshimtë paraprakisht me telefon tek autoriteti përgjegjës, të shoqëruar me shkresë zyrtare, sipas afatit të pikës 1 të këtij neni.

Neni 10

Raportimi i transaksioneve të vlerave tek autoriteti përgjegjës

1. Subjektet janë të detyruara të raportojnë tek autoriteti përgjegjës, brenda pesë ditëve pune nga data e kryerjes, të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja, kryer si një transaksion i vetëm, ose në disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën brenda 72 orëve.

2. Në funksion të zbatimit të pikës 1 të këtij neni, subjektet do të konsiderojnë si të kryera në para fizike çdo transaksion që nuk është i shoqëruar me një dokument justifikues bankar.

3. Subjektet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të nenit 3 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar, janë të detyruara të raportojnë tek autoriteti përgjegjës, brenda pesë ditëve pune nga data e kryerjes, të gjitha transaksionet jo në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën brenda 72 orëve.

Neni 11

Inspektimi dhe trajnimet

1. Autoriteti përgjegjës kontrollon, me anë të inspektimeve, vetëm ose në bashkëpunim me autoritetet mbikëqyrëse, zbatimin e detyrimeve ligjore dhe vlerëson përmbushjen e tyre nga subjektet.

2. Autoritetet mbikëqyrëse/ licencuese, vetëm ose në bashkëpunim me autoritetin përgjegjës, hartojnë dhe zbatojnë programe informimi dhe trajnimi të subjekteve, lidhur me ndryshimet ligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

3. Mbi bazë të kërkesës së autoritetit përgjegjës, plotësohet dhe raportohet nga subjektet raporti i vetëkontrollit, në lidhje me përmbushjen prej tyre të detyrimeve ligjore. Subjektet vënë në dispozicion të dhëna dhe dokumente të hartuara e miratuara prej tyre në funksion të vlerësimit nga autoriteti përgjegjës të përputhshmërisë së programeve dhe të sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit.

Neni 12

Detyrimet e ruajtjes së të dhënave

Subjektet duhet të ruajnë dokumentacionin për identifikimin, llogaritë, si edhe korrespodencën me klientin për 5 vjet nga data e mbylljes së llogarisë apo përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit. Me kërkesën e autoritetit përgjegjës, dokumentacioni ruhet nga subjektet për më shumë se 5 vjet.

Të dhënat e siguruara për klientët nga subjektet dhe masat e marra prej tyre në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7 dhe 8 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar, dokumentohen, administrohen rregullisht dhe vihen në dispozicion të autoritetit përgjegjës mbi bazë të kërkesës së këtij të fundit, jo më vonë se 15 ditë kalendarike, apo si dokumente shtesë për arsyetimin e dyshimeve rast pas rasti.

Neni 13

Dispozita të fundit

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi dhe anekseve dhe instruksioneve bashkëlidhur, si pjesë organike të tij:

a) Aneksi I "Raporti për aktivitetin e dyshimtë" (RAD);

b) Aneksi II “Raporti i transaksioneve të parasë fizike” (RTPF);

c) Aneksi III “Raporti i transaksioneve të vlerave” (RTV);

d) Aneksi IV “Raporti i vetëkontrollit”,

ngarkohen subjektet e përcaktuara në nenin 3, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “e”, “ë”, “f” dhe “k” të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

2. Për kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohet “autoriteti përgjegjës” - Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP).

3. Ky udhëzim, së bashku me anekset I, II, III dhe IV, do të jenë të vetmet standarde të pranueshme për raportim tek “autoriteti përgjegjës”, të cilat mund të pësojnë ndryshime në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzimi nr.12, datë 5.2.2009 “Për metodat dhe procedurat e raportimit të subjekteve raportuese të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i Ministrit të Financave, së bashku me anekset përkatëse, shfuqizohet.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode